L I G J
Nr. 8711, datë 15.12.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 14 **"Shkeljet"** ndryshohet si vijon:
"Kundërvajtjet administrative.
Veprimet ose mosveprimet e mëposhtme sipas kreut II të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative:
a) Mosdokumentimi i pagesave të kryera, mosllogaritja dhe mosmbajtja e tatimit në burim, si dhe fshehja ose falsifikimi i të dhënave për të ardhurat e paguara për çdo tatimpagues.
b) Mosdeklarimi dhe mosderdhja në mënyrë korrekte e detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale nga individët që detyrohen të bëjnë një gjë të tillë, në zbatim të nenit 13 të këtij ligji.
c) Mosderdhja në buxhetin e shtetit nga agjentët tatimorë të tatimit të llogaritur.
ç) Mosmbajtja e regjistrimeve për të ardhurat e paguara tatimpaguesve dhe për tatimet e mbajtura, të cilat janë transferuar në buxhet, duke përfshirë mbajtjen e regjistrimeve për çdo tatimpagues.
d) Paraqitja me vonesë e deklaratës së të ardhurave personale, e kërkuar në zbatim të nenit 13 të këtij ligji.
dh) Mospagimi i detyrimeve tatimore në afatet e përcaktuara në këtë ligj."

Neni 2

Neni 15 **"Dënimet"** ndryshohet si vijon:
"Kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 14 të këtij ligji dënohen si vijon:
a) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjave "a", "b" dhe "c" të nenit 14, personat përgjegjës, përveç shumës së detyrimit të tatimit, paguajnë edhe një dënim të barabartë me shumën e këtij detyrimi tatimor.
b) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës "ç" të nenit 14, personat përgjegjës dënohen me gjobë në masën 10 mijë lekë.
c) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës "d" të nenit 14, personat përgjegjës dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë.
ç) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës "dh" të nenit 14, personat përgjegjës paguajnë interesa për pagesë të vonuar në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".
Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 3

Neni 28 **"Shkalla tatimore"** ndryshohet si vijon:
"Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin është 25 për qind."

Neni 4

Në fund të paragrafit të parë të nenit 29 **"Deklarimi tatimor"** shtohen:

"Paraqitja e deklaratës vjetore e të ardhurave të tatueshme, e bilancit kontabël dhe e llogarisë së fitimeve dhe humbjeve nuk do të thotë miratim i të dhënave të tyre për qëllime fiskale nga ana e administratës tatimore edhe pse ato mund të jenë certifikuar nga ekspertë kontabël. Për qëllime fiskale të dhënat e këtyre dokumenteve konsiderohen të pranuara vetëm pasi ato të jenë kontrolluar nga ana e administratës tatimore."

Neni 5

Neni 31 **"Shkeljet"** ndryshohet si vijon:

"Kundërvajtjet administrative.

Veprimet apo mosveprimet e mëposhtme, sipas Kreut III të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative:

a) Mospasqyrimi i saktë i të ardhurave dhe shpenzimeve nga veprimtaria me efekt në rezultatin financiar.

b) Falsifikimi i të dhënave dhe i dokumentacionit për të ardhurat dhe shpenzimet.

c) Mosparaqitja brenda afatit kohor e deklaratës tatimore dhe e bilancit kontabël së bashku me anekset e tij.

ç) Mosrespektimi i afatit të përcaktuar në këtë ligj për pagimin e tatimit.

d) Mbajtja e gabuar e llogarive, pa pasoja në rezultatin finaciar."

Neni 6

Neni 32 **"Dënimet"** ndryshohet si vijon:

"Kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si vijon:

a) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjave "a" dhe "b" të nenit 31 të këtij ligji, personat përgjegjës, përveç shumës së detyrimit të tatimit, paguajnë edhe një dënim të barabartë me shumën e këtij detyrimi tatimor.

b) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës "c" të nenit 31 të këtij ligji, personat përgjegjës dënohen me gjobë në masën 40 mijë lekë.

c) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës "ç" të nenit 31 të këtij ligji, personat përgjegjës paguajnë interesa për pagesë të vonuar, në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

ç) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës "d" të nenit 31 të këtij ligji, personat përgjegjës dënohen me gjobë 10 mijë lekë.

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"."

Neni 7

Paragrafi 6 i nenit 38 **"Dispozita Kalimtare"** ndryshohet si vijon:

"Tatimpaguesit, që kanë përfituar lehtësi tatimore në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 7677, datë 3.3.1993 "Për tatimin mbi fitimin", i gëzojnë këto lehtësi sipas kushteve të parashikuara në ligjin e mësipërm."

Neni 8

Pasqyra nr.1 që i bashkëlidhet ligjit ekzistues, zëvendësohet me pasqyrën nr. 1 që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Shpallur me dekretin nr.2848, datë 26.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

PASQYRA NR. 1

E ARDHURA E TATUESHME MUJORE	TATIMI MBI TË ARDHURËN PERSONALE MUJORE

MBI (Në lekë)	DERI (Në lekë)	Lekë	Përqindje
0	10 000		Pragu përjashtues
10 000 +	20 000	0	+ 5 % të shumës mbi 10 000
20 000 +	30 000	500	+ 10 % të shumës mbi 20 000
30 000 +	50 000	1 500	+ 15 % të shumës mbi 30 000
50 000 +	80 000	4 500	+20 % të shumës mbi 50 000
80 000 +	Më tepër	10 5000	+ 25 % të shumës mbi 80 000